



P.nr.67/2016

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, DEGA NË NOVOBËRDË -
Departamenti i përgjithshëm, përmes gjyqtarit Hasan Sadiku, me proqesmbajtjen Fjolla Huruglica, në lëndën penale kundër të akuzuarve B G nga fshati , Komuna e Malishevës, dhe F E nga të cilin e përfaqson av.Faruk Brestovci nga Gjilani, për shkak të veprës penale, Rrezikimi i Trafikut Publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, PP.II. nr. 1793/ 2016, të datës 24.10.2016, të cilën e përfaqësonte Prokurori i Shtetit, Mr.sc. Ismet Ukshini, pas mbajtjes së seancës fillestare dhe publike, më 13.02.2017, ndërsa me 14.02.2017 mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari B G, pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati R , dhe e ëma M ; e lindur M , i lindur më 27.08.1946 në fshatin , Komuna e Malishevës, ku edhe jeton, shqiptare, shtetasë i R. Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, pensionist, i martuar, baba i shtatë fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, deri me tani i pa gjykuar dhe nuk udhëhiqet procedur tjetër penale ndaj tij.

I akuzuari F E, pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati A , dhe e ëma Z , e lindur H , i lindur më 16.04.1996, në , me vendbanim në , rruga , shqiptare, shtetasë i R. Kosovës, Student i vitit të dytë Fakultetit Ekonomik, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa gjykuar deri më tani dhe nuk udhëhiqet procedur tjetër penale ndaj tij.

Janë fajtorë

I akuzuari B G

Sepse: më datë 25.09.2016 rreth orës 08:50h , në rrugën Prishtinë Gjilan përkatsishtë në fshatin Parallovë, Komuna Novobërdës, derisa e ka drejtuar automjetin e markës „VW Golf 19E”, me tab. Regj. 07-721-BH, nga pakujdesia ka shkukur ligjin mbi Sigurimin e Komunikacionit Ruugor nga neni 42,I, përkatsishtë i njejtë duke bërë kyqje të pasigurtë nga parking në magjistralen Prishtinë- Gjilan, pa u bind se një veprim të tillë do ta kryej, pa i rrezikuar pjesmarrsit në komunikacion me që rast në pjesën e parë të anës së majtë të automjetit të tij godet në pjesën e parë të anës së djathtë automjetin e markës, „ VW Golf 1K”, me table te regj. [redacted], të cilin e drejtonte [redacted], i cili qarrkullonte në rrugën magjistrale Prishtinë –Gjilan, me që rast përpos dëmeve matreale në këto automjete lëndime trupore pësojn i dëmtuari i automjetit A. [redacted] sh. [redacted] dhe F. [redacted] E [redacted] të cilët për shkak të lëndimeve të pësuar detyrohen të kërkkojn ndihmë mjeksore në spitalin regjional të Gjilanit- gjegjesisht Qendra Emergjente në Gjilan.

-me çka ka kryer veprën penale, rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

I akuzuari [redacted] E

Sepse, në kohën vendin dhe mënyrën si në dispozitivin e I, të këtij aktgjykimi, i akuzuari F [redacted] E [redacted], derisa ka lëvizur në rrugën magjistrale Prishtinë -Gjilan, me automjetin e tij të markës „VW Golf 11”, me tabela të regj. [redacted], duke mos mbajtur distancën e sigurisë dhe duke mos ja përshtatur shpejtsinë automjetit të tij , kushteve të rrugës, me qëllim që automjetin e tij ta ndali para cdo pengese që paraqitet në rrugë, del jashtë rrugës në anë të majtë të drejtimit të lëvizjes së pari fërkohet me automjetin i cili ishte duke lëvizur para tij, të cilin e drejtonte i dëmtuari A [redacted] sh. [redacted] dhe me pjesën e përparme të automjetit të tij e godet mbrojtësin e urës, dhe si pasojë e këtij aksidenti përpos dëmeve matreale në këto automjete lëndime trupore pësojn vet i pandehuri dhe drejtuesi I automjetit akuzuari dhe drejtuesi I automjetit A [redacted] Sh. [redacted], të cilët për shkak të lëndimeve të pësuar detyrohen të kërkkojn ndihmë mjeksore në spitalin regjional të Gjilanit- gjegjesisht Qendra Emergjente në Gjilan.

-me çka ka kryer veprën penale, rrezikimi i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4,41, 46,51, 52,64,73,74, 75 dhe 76 të KPRK-së, lidhur me nenin 365 të KPPRK-së,

I GJYKON

Të akuzuarit: B. G. dhe F. E.

Me dënim burgu në kohë zgjatje prej nga 90 (nëntë dhjetë) ditë, të cilët dënime nuk kanë për tu ekzekutuar në qoftë se të akuzuarit në afat prej 1 (nji) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, në të kundërtën ky dënim i kushtëzuar do të revokohet.

Të akuzuarit obligohen ti paguajn të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipa llogaris përfundimtare të gjykatës edhe në emër të paushallit gjyqsor sejcili shumën prej nga 20€.

I dëmtuari A. Sh. nga Gjilani, për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore, në Gjilan, me aktakuzën e ushtruar me shkrim, PP.II.nr.1793/2016, të datës 24.10.2016, i ka akuzuar B. G. nga fsh. Komuna e Malishevës, dhe F. E. nga, për shkak të veprave penale, Rrezikimi i Trafikut Publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit Mr.sc. Ismet Ukshini, në seancën fillestar ka deklaruar: së pari e bëj korigjimin e aktakuzës në dispozitivin II në rreshtin e shtatë ashtu që fshihen fjalët i akuzuari i pare E. G., dhe në në vend të këtyre fjalëve shtoj fjalët i dëmtuari A. Sh. kurse pjesa tjetër mbetet e pandrushueshë, si dhe propozoj që të akuzuarit të shpallen fajtorë për veprat e kryera dhe të njejtëve ti shqiptohet denimi meritor sipas ligjit, gjithnji duke i marrur për bazë të gjitha rrethanat si ato lehtsuese ashtu edhe ato rënduese.

I akuzuari B. G. në seancën fillestare ka deklaruar: e kamë kuptuar aktakuzën e lexuar, e ndiej vehten fajtorë, dhe e pranoj fajësinë për veprën të cilën ma vënë në barrë e njehta, pendohem për këtë vepër të kryer, dhe i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të kësaj natyre, dhe kërkoj nga gjykata që brenda mundësive ligjore të më shqiptoj një dënim sa më i butë.

I akuzuari F . . . E . . . në seancën fillestare ka deklaruar: e kamë kuptuar aktakuzën e lezuar e ndiej vehten fajtores, dhe e pranoj fajësinë për veprën të cilën ma vënë në barrë e njejtë, pendohem për këtë vepër të kryer , dhe i premtoj gjykatës se në të ardhmen nuk do të bie ndeshë me ligjin, dhe kërkoj nga gjykata që të më shqiptoj një dënim sa më i butë.

Meqenëse se të akuzuarit e kanë pranuar fajësinë akuzuarit B . . . G . . . dhe F . . . E . . . , e kanë pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, e me këtë, sipas vlersimit të kësaj gjykate gjendja faktike në kër qështje penale nuk është kontestuese, sepse pos pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarve, një pranim i tillë i fajësisë ks mbshitetje edhe në provat e grumbulluara në shkresat e lëndës siqë janë deklaratat e të akuzuarve, deklaratat e dëshmitarëve të dhëna para policisë, skicat nga vendi i ngjarjes si dhe fotodokumentacioni i hartuar në vendin e ngjarjes sikur edhe raporti mjeksor i lëshuar nga Spitali Regjional në Gjilan, se të njejtit vullnetarisht e kanë pranuar fajësinë se ky pranim është bërë pasi që të njejtit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, andaj gjykata fare pa shkuar në shqyrtimin gjyqësor dhe pa fjalën përfundimtare të palëve duke vepruar në pajtim me dispozitën e nenit 248 të KPPK-ës,

Me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit për të akuzuarët, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat sikurse ato lehtsuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në përcaktimin e dënimit në pajtim me nenin 73 të KPRK-ës, dhe kështu si rrethana lehtsuese për të akuzuarit gjykata mori për bazë sjelljet korrekte gjat séances së shqyrtimit gjyqësorë, pranimin e fajësisë, si dhe pendimin për veprat e kryera, premtimin se në të ardhën nuk do të kryejn vepra tjera penale gjendjet e tyre ekonomike dhe familjate, se I akuzuari B . . . G . . . është pensioner dhe baba i shtatë fëmijve, ndërsa I akuzuari F . . . E . . . student i vitit të dytë, ndërsa si rrethana rënduese, shkallën e përgjegjësisë penale, dhe pasojat e shkaktuar nga këto vepëra penale, dhe duke i marrë për bazë të gjitha këto fakte të njejtëve iu shqiptoi dënimin sin ë dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se edhe me këto denime do të arrihet qëllimi i dënimit i parapar me ligj në mënyrë që të akuzuarit ti parandaloj nga kryerja e veprave penale në të ardhmën dhe të bëj rehabilitimin e tyre dhe të parandaloj edhe personat tjer nga kryerja e veptave penale.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 453 parag. 1, e në lidhje me nenin 450 parag.1 nën parag. 2 .6 të KPPRK-së.


I dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontestin civil në pajtim me nenin 463 të KPPK-ës.

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, DEGA NË NOVOBËRDË.

- Departamenti i pergjithshëm.

P.nr. 67/2016, më 14.02.2016



Antari:

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa dorzohet për mes kësaj gjykate.

